# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-454349**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kredo vijon të zhvatë qytetarët, si mikrokredia me filozofi grabitqare i ktheu në mjet fitimprurës interesat e larta të huasë. Fitoi 6.3 mln euro në 1 vit |
| ADRESA | `https://shqip.com/kredo-vijon-te-zhvate-qytetaret-si-mikrokredia-me-filozofi-grabitqare-i-ktheu-ne-mjet-fitimprures-interesat-e-larta-te-huase/` |
| BURIMI | shqip.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 08:47:39 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 19:53:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `910fc2f5cf30c5c6bf5d8f7f01421d008d9e6056754aed9fbda3d65597cc936a` |
| TEKSTI | `0d3de4984e33ee92bce246dc89e78c6605837dd842a404902e346000c8969b2b` |
| PAMJA | `4900600b2772012f952fb3fa8eb4b01c20a3d95b63bef862c236e205d5b8b56b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5301d31138840aeeeb85964e4030f32e8169204739fb76de92a028dcaf2e40fa` |
| E MËPARSHMJA | `c3048a99b2cae61b4827a614f9da2dfce9a70d89e499efd639f267d8eae3ef17` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5301d31138840aeeeb85964e4030f32e8169204739fb76de92a028dcaf2e40fa`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Lajme

# Kredo vijon të zhvatë qytetarët, si mikrokredia me filozofi grabitqare i ktheu në mjet fitimprurës interesat e larta të huasë. Fitoi 6.3 mln euro në 1 vit

Shqip

Publikuar: (19.09.2026 21:53:00)




Share

Teksa tregu i mikrokredive në Shqipëri vazhdon të lëkundet nga pasojat e skandaleve të bujshme të mashtrimit ndërkohë që aktorët kryesorë të këtij sektori vijojnë të arkëtojnë fitime stratosferike.

Kompania ECFA, e njohur gjerësisht për publikun si Kredo, ka mbyllur vitin e kaluar me një fitim neto pas taksave prej 593.2 milionë lekësh ose 6.3 milionë euro, duke u renditur mes dy kompanive të mikrokredisë që aplikojnë normat më të larta të interesit në vend. Por edhe duke dëshmuar se modeli i biznesit të bazuar tek zhvatja e qytetarëve vijon të mbetet jashtëzakonisht fitimprurës.

Skandali i madh i MCA-së dy vite më parë dukej se do të trondiste përfundimisht themelet e këtij tregu të pakontrolluar, por realiteti tregon se strukturat e mikrokredive komerciale vazhdojnë të funksionojnë me të njëjtën filozofi grabitqare ku vetë ECFA e financon aktivitetin e saj me hua me interes rreth 13.5 për qind në vit të siguruara nga bankat, aksionerët ose përmes emetimit të obligacioneve, të cilat më pas jepen si kredi për qytetarët me interesa edhe më të larta.

Përballë denoncimeve të njëpasnjëshme për skema mashtruese dhe zhvatje të huamarrësve, Banka e Shqipërisë thotë se ka ndërhyrë disa herë për të vendosur fre dhe interesi maksimal mbi kredinë konsumatore u kufizua në 51.3%.

Megjithatë, kjo shifër mbetet tejet e lartë dhe modeli i mikrokredive vijon të mbështetet te normat e kripura. Kjo qasje duket më shumë si një legalizim i fajdesë institucionale sesa si mbrojtje reale për konsumatorin, duke lënë të kuptohet se fitimet miliona euro të korporatave në kurriz të qytetarëve të zhytur në borxhe mbeten një nga plagët më të rënda të tregut financiar.

©Shqip.com

TË FUNDIT N'SHËNJESTËR


1 "Tigrat e Vlorës", tenderi 23 milionë dollarësh dhe mekanizmi që ngre pikëpyetje. SPAK mjafton të ndjekë… paratë
Lajme


2 Safet Gjici u rikthehet tenderave të dyshimtë pas lirimit nga burgu, në skenë Etjen Xhafaj i Postës Shqiptare, ish-kryebashkiaku mbi 100 milionë euro kontrata publike me dy kompani
Lajme


3 Kadastra e Lorena Goxhobellit, një moçal skandalesh dhe aferash pa fund!
Lajme


4 Deklarata e fortë: Kompania që u kap me 41 kg kokainë (AMG Food e Arben Goxha), përfitoi nga Qeveria 1 mln € nga fondet e IPARD
Lajme


5 Nga Greta Beqiri punonjëse e zyrës së shtypit te profilet anonime/ Pyetjet e porositura të PD-së po e bëjnë Berishën qesharak. Bashkëbisedimi i të shtunës kthehet në parodi
Lajme


6 Iute Credit "shtrydh" shqiptarët me interesat ekstreme të kredive, mbush thasët në Shqipëri dhe transferon miliona euro në Estoni
Lajme


7 Non grata/ Berisha e pranon: Vizën amerikane e mora me lobim, sa para u paguan… Jam i sigurt që Trump e lexoi letrën që i dërgova
Lajme


8 Banka JET/ Qarkullon paratë e Forex? Si u trash kapitali nga 3 mln lekë në 26 milionë €! Ndryshoi emrin dhe manovra mes bosëve izraelit Louis Grant Silver e Idan Avishai
Lajme


9 "Botoxi" kontrabandë, Dritan Gremi i "Gremi Wellness" përfundon në Gjykatë, por si shpëtoi për të njëjtat akuza doktori i VIP-ave, Skerdi Faria i "Keit"
Lajme


10 Merret i pandehur Dritan Gremi, pronar i "Gremi Wellness" dhe 11 qendrave estetike. Akuzohet për kontrabandë botoxi dhe evazion fiskal
Lajme




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.